

EDMOND MALAJ

FAMILJA FISNIKE BRUTI NGA DURRËSI

I

Në Mesjetë, në lidhje me emrin Bruti apo Bruto gjejmë shumë persona që janë të dokumentuar me një mbiemër të tillë¹ sidomos gjatë shek. XV, por unë këtu do të trajtoj të dhëna rreth familjes fisnike Bruti me origjinë nga Shqipëria e Mesme, më saktësisht nga Durrësi², siç e cilëson kështu edhe një *“Relacion anonim mbi qytetin e rrethin e Ulqinit dhe mbi disa vende të tjera të Shqipërisë”* i vitit 1571.³ Familja Bruti është një ndër familjet me të shquara mesjetare



Fig. 1: Stema e familjes Bruti

¹ Në fakt me të njëjtin mbiemër është e dokumentuar edhe një familje tjetër në Venedik, nga e cila rrjedhin këta persona: Eugenio Bruto njohës i greqishtes që përgatiti për botim disa vepra të Aristotelit (viti 1496); Gianmichelle Bruto nga Venediku (viti 1497); Giovanni Bruto, që është i dokumentuar si dëshmitar në një gjyq (viti 1495); Niccolo Bruto që nguli këmbë në Senatin venedikas për Abacinë e Shën Justinës në Padova (viti 1495), për të cilët jemi të mendimit që nuk bëhet fjalë për pinjoll të kësaj familjeje shqiptare fisnike, por për qytetarë të ndryshëm venedikas me të njëjtin mbiemër. Shih për këtë: *Notizie storico-critiche intorno la Vita, le Opere degli Scrittori Viniziani*. Raccolte, esaminate e distese da F. Giovanni degli Agostini de Minori della Osservanza, Bibliotecario in S. Francesco della Vigna nella Citta di Venezia sua Patria. Venezia: Presso Simone Occhi MDCCLII, f. 570.

² *Dizionario universale della Lingua Italiana ed insieme di Geografia (antica e moderna); Mitologia; Storia (sacra, politica ed ecclesiastica); Biografia; Antiquaria; Storia Naturale; e di tutti i vocaboli d'origine greca, usati nella Medicina, Chirurgia, Farmacia, Chimica, Fisica, Astronomia, Teologia e Giurisprudenza, preceduto da una Esposizione Grammaticale e Ragionata della Lingua Italiana di Carlo Ant. Vanzon*. Tomo Primo A-B. Livorno: Sardi e Figlio 1828, f. 628.

³ *Dokumente të shekujve XVI – XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. I (1507 - 1592), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, nr. 231, f. 296.

shqiptare edhe pse ajo sot në historiografinë shqiptare është mjaft e panjohur. Nga gjiri i familjes Bruti dolën shumë njerëz të shquar, ndër ta klerikë nga të cilët disa prej tyre arritën rangun e ipeshkvit, pastaj më tej edhe shkrimtarë⁴, luftëtarë, burra shteti dhe përkthyes⁵, nga emrat e të cilëve do të krijohej një listë e gjatë po t'i përmendnim të gjithë. Brutët i përkasin atyre familjeve fisnike të shumta shqiptare që braktisën atdheun e tyre Shqipërinë për shkak të pushtimit osman dhe u vendosën në territorin e Istrias. Familje të tjera që u vendosën aty mund të përmendim edhe familjet Borisi apo Bruni. Lidhjet e kësaj familje me qytetin e Durrësit dhe më vonë edhe me qytetin e Ulqinit janë tashmë të dokumentuara, edhe pse dokumentet ekzistuese në lidhje me to janë të pakta⁶. Sipas një përshkrimi nga veneciani Gian Battista Giustinian, familja Bruti mund të kishte një origjinë të vjetër romane, “nga familja e famshme romane Brutus”⁷. Megjithatë N. Malcolm është i mendimit që origjina romane e kësaj familjeje shqiptare është e pabazuar dhe e diskutueshme, pasi në mesjetë ishte e modës që familje fisnike shqiptare, për t'i dhënë një ngjyrë mundësisht më fisnike mbiemrave të tyre familjarë i latinizonin ato dhe u jepnin gjoja një origjinë romane.⁸

⁴ Si të tillë mund të përmendim këtu Alessandro Brutin (1611), nga Capodistria për të cilin pothuajse nuk dimë asgjë tjetër. Pietro Stancovich, *Biografia degli uomini distinti dell' Istria, del canonico Pietro Stancovich, socio di varie Academie*, Tomo Secondo, Trieste: Marenigh 1829, f. 230.

⁵ Studiuesi sloven Salvator Žitko me të drejtë konstaton: “*I Bruti si distinsero al punto di meritarsi pubblici incarichi e elogi. Così troviamo I discendenti dei Bruto nelle file dei dragomani – interpreti e traduttori presso la Porta ottoman di Costantinopoli accanto a Tarsia e ai Carli. Le origini albanesi e dalmate dei Bruti li rendevano incline a intraprendere la carriera diplomatica, conoscevano infatti la lingua turca, Albanese e una delle lingue slave, nell' ambiente Veneto avevano studiato anche il Greco e il latino.*” Salvator Žitko, “Plemiška Družina Bruti in njena vloga v družvebem, verskem in Kulturnem življenju beneškega Kopra”, në *Il palazzo e la famiglia Bruti a Capodistria, coi libri del vescovo Agostino conte Bruti*, Koper Capodistria 2014, f. 101. (= Bibliotheca Iustinopolitana N. 6).

⁶ Autori i këtij artikulli ka konsultuar një numër të konsiderueshëm vëllimesh dokumentare dhe ka mundur të gjejë deri tani pak dokumente në lidhje me historinë e tyre.

⁷ Noel Malcolm, *Agents of Empire. Knights, Corsairs, Jesuits and Spies in the Sixteenth Century Mediterranean World*. Oxford: University Press 2015, f. 23.

⁸ Po aty, f. 25.

II

Origjinën e tyre Brutët pretendohej se e kishin romake, më saktë nga Brutët romakë, “disa mbeturina të së cilës qëndruan në ato anë, pas përleshjes së madhe që ngjau në Durrës ... midis Cezarit dhe Pompeut të madh”⁹. Familja Bruti pretendohet se ishte zotëruese e Durrësit në shekullin XIII. Personat e parë të dokumentuar të saj janë Marco Bruti nga Durrësi që përmendet si i lindur në atë qytet në vitin 1285, i cili cilësohet si zot i Durrësit.¹⁰ Të dhëna të tjera mbi Markon nuk kemi mundur të gjejmë akoma, por dimë që ishte i martuar me Maria Capelichion dhe nga kjo martesë lindi më 1316, Cristoforo Bruti.¹¹ Mesa duket Capelichiot ishin një familje fisnike në Durrës, e panjohur deri më sot, pasi të dhëna mbi këtë familje pothuajse nuk kemi fare. Me këtë familje Brutët patën edhe lidhje të tjera, sepse në vitin 1474 na del edhe një martesë tjetër e Barnaba Brutos me Gioa Capelichion e cila në burime të tjera quhet edhe Gioa me origjinë nga Coppelicho Albanese (Kopliku ??).¹² Nëse familja Capelichio (apo Coppelicho) ka lidhje me fshatin e madh verior shqiptar Koplik, i cili në mesjetë kishte një prani të dendur sllave, kësaj pyetjeje për momentin nuk mund t’i përgjigjemi akoma, për shkak të mungesës së burimeve dokumentare.

Kristofori (Cristoforo) i lindur më 1316, me shumë mundësi në Durrës, është pasardhësi i dytë i dokumentuar i kësaj familje dhe u martua me Susanna Shpanin. Ja pra edhe një lidhje tjetër politikisht e rëndësishme për atë kohë. Familja Shpani nga Drishti (Drivasto) ka qenë një ndër familjet më të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht në Shqipërinë Veriore mesjetare dhe është e dokumentuar mjaft mirë.¹³ Kjo familje ishte shumë e pasur dhe siç thotë Farlati, pasuritë e saj në Shqipëri lulëzonin (*illustri Genere Spanorum, qui opibus copiisque in Albania florebant*).¹⁴ Në mbështetje të këtij fakti mund të përmendim që

⁹ *Dokumente të shekujve XVI – XVII ...*, vëll. I (1507 - 1592), nr. 231, f. 296.

¹⁰ Domenico Venturini, *La famiglia Albanese dei Conti Bruti*. Parenzo: Tipografia Gaetano Coana 1905, f. 7; shih edhe: S. Žitko, “Plemiška Družina Bruti ...”, f. 101.

¹¹ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, f. 7.

¹² G. Agostini, *Notizie storico-critiche ...*, f. 495.

¹³ Për të dhëna të tjera në lidhje me Shpanët shih Edmond Malaj, “Familje fisnike të Drishtit mesjetar”, në *Studime historike*, nr. 3-4, 2013, Viti LXVII (L), f. 33-44.

¹⁴ *Illyrici Sacri*, Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput

në kadastrën e Shkodrës të vitit 1416-1417 përmenden shumë Shpanë, të cilët janë të përhapur gjithkund nëpër rrethinat e Shkodrës dhe ishin pronarë tokash dhe fshatrash. Ata kishin privilegje edhe nga zotërimi venedikas. Lidha e Brutëve me këtë familje dëshmon për fuqinë dhe rëndësinë e tyre në Shqipërinë Mesjetare.

Nga martesja e Kristoforo Brutit me Susanna Shpanin, u lind në vitin 1348, Barnaba Bruti i cili mori për grua Elena Dukën. Kjo ka qenë një pinjolle e familjes fisnike të fuqishme Duka në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore mesjetare. Duka si mbiemër familjar sot gjendet dendur pothuaj se në të gjithë territorin shqiptar. Nga kjo lidhje martesore, u lind në vitin 1382, Giacomo Bruti. Ai u lidh me një familje tjetër të njohur fisnike, duke marrë për grua Catarina Svinjan. Se nga cila krahinë e Shqipërisë ishte Catarina kjo nuk mësohet nga burimet që kemi në dispozicion, porse familja Svinja është mjaft e dokumentuar në Drisht, në Shkodër¹⁵ dhe në krahinat e Dalmacisë bregdetare.

Etimologjikisht, sipas Shuflajt, Jirečekut dhe Talloscit, ky mbiemër vjen nga fjala sllave *svinja* që don të thotë *thi, derr*. Mesa duket kjo familje ka një origjinë sllave. Por duhet të përmendim këtu që fjala *Suinis* edhe në latinisht ka lidhje me fjalën *thi derr* (*suinis* = mbiemër gjinia fem., rasa gjinore). Jirečeku e bën të pranishme familje fisnike Svinis edhe në Ulqin (*Svino, Nobiles von Dulcigno im XV. Jahrhundert, de Suyno 1505, de Suinis 1521*)¹⁶. Nga lidhjet e Brutëve me familjen Svinja dokumentohet edhe një martesë tjetër që është e dokumentuar në vitin 1520, midis Bona Brutit dhe Lavio Suinas.¹⁷

Një lidhje tjetër e rëndësishme e Brutëve me familjet mesjetare është edhe martesja e Bartolomeo Brutit me Laura Dukagjinin (Laura Ducaina). Dukagjinët kanë qenë një familje e fuqishme në veri të Shqipërisë të cilët morën pjesë në mënyrë aktive në luftën kundër osmanëve gjatë shek.

Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004.), f. 85.

¹⁵ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës (1416-1417)*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1977, fl. 3a; 9ab, 23 b, 24 ab, 30 b, 35 a, 129 a, 133 b, 137 b, 158 b.

¹⁶ Constantin Jireček, "I. Abhandlung: Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters. II. Theil", në *Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften*. Philosophisch-historische Klasse. Neunundvierzigster Band. Wien: Carl Gerolds Sohn 1904. f. 64.

¹⁷ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, pa f., shih gjenealogjinë në fund të kësaj veprë.

XV.¹⁸ Bartolomeo ishte nënbailoz (vicebailo) dhe kapiten i Durrësit.¹⁹ Nga martesë e Bartolomeos me Laura Dukagjinin lindën shumë fëmijë por këtu ia vlen të përmendet Barnaba, i cili u shqua si dragoman, por pati një fat të keq, sepse ra në duart e osmanëve dhe vdiq nën tortura në vendin e quajtur “Shtat kullat” (Sette Torri) në Konstandinopojë.²⁰ Ndër lidhjet e Brutëve me Dukagjinët është dokumentuar edhe një martesë tjetër ndërmjet Oria Brutit me Giovanni Ducaino, e dokumentuar në vitin 1529.²¹

Vazhdimësinë e traditës së lidhjes me familje të fuqishme e vazhdojnë më tej të tjerë, si p. sh. Antonio Bruti, i cili u martua me Oria Kastriotin, një të afërme e Heroit Kombëtar Shqiptar Gjergj Kastrioti. Familja e Kastriotëve ka qenë e famshme dhe ka pasur territoret e saj në krahinat e Matit të Dibrës dhe të Krujës²². Me Gjergj Kastriot Skënderbeun në krye u bë pararojë e luftës kundër pushtuesve osmanë gjatë shek. XV. Antoni ishte nënbailoz (vicebailo) i Durrësit dhe mori pjesë aktive në mbrojtjen e këtij qyteti, luftoi me trimëri, deri sa përfundoi i zënë rob dhe vdiq nën robërinë turke.²³ Në lidhje me këtë ngjarje për vitin nuk ka të dhëna. Sipas gjenealogjisë që jep Venturini, nga martesë e Antonios me Oria Kastriotin lindi Barnaba, i cili pati si bashkëshorte Gioa Capelichion.²⁴ Në burime të tjera quhet edhe Gioca me origjinë nga Coppelicho Albanese²⁵ (Kopliku ??) këta i përmendëm edhe më sipër. Mbi vitet e tyre të lindjes dhe periudhën kur jetuan nuk kemi të dhëna, por jemi të mendimit që jetuan aty rreth mesit të shek. XV. Barnaba, porsì të parët e tij ishte luftëtar dhe gjatë mbrojtjes së Durrësit ndaj osmanëve mbeti i plagosur rëndë.²⁶

¹⁸ Shih: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, botuar nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1985, f. 212.

¹⁹ Giuseppe Bonzi, *Ne funerali dell Illustriss., e Reverendiss. Monsig. Agostino Bruti Vescovo di Capodisstria*. Orazione die Giuseppe Bonzio delta il 7 Settembre dell Anno 1747. Venezia: Francesco Storti 1748, XIV.

²⁰ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, f. 7.

²¹ Po aty, pa f., shih gjenealogjinë në fund.

²² Edmod Malaj, “Disa reflektime mbi origjinën e Kastriotëve”, në *Sesionin Shkencor “610-vjetori i lindjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu”*, maj 1405-maj 2015, Tiranë: ILAR, 2015, f. 48-61.

²³ G. Bonzi, *Ne funerali dell Illustriss ...*, f. XIV.

²⁴ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, pa f., shih gjenealogjinë në fund.

²⁵ G. Agostini, *Notizie istorico-critiche ...*, f. 495.

²⁶ G. Bonzi, *Ne funerali dell Illustriss ...*, f. XV.

Barnaba dhe Gioa ishin prindërit e të famshmit Piero Bruto, i cili është i dokumentuar fare mirë në gjysmën e dytë të shek. XV. Në lidhje me figurën e Piero Brutit, ia vlen të hapim një parantezë dhe të ndalemi pak për të dhënë një skicë të shkurtër të jetës dhe të aktivitetit të tij. Emri i tij është futur tashmë nëpër vepra që flasin mbi shkrimtarët venecianë sidomos të periudhës së Rilindjes së Vonë. Le të kthehemi tani sërish në Shqipëri. Lidhja e tretë me familjen Capelichio është e dokumentuar në vitin 1477, ku Giorgia Bruti u martua me Marco Capelichion.²⁷

Me pushtimin e Durrësit nga osmanët më 13 gusht 1501, kjo familje u largua nga ky qytet. Personi që është i dokumentuar në lidhje me këtë largim, sipas disa burimeve, është Barnaba Bruto, i cili pas pushtimit të qytetit arriti të shpëtonte e të largohej i vetëm duke u rimëkëmbur në Ulqin.²⁸ Duket se nga kjo familje shpëtoi vetëm Barnaba, i cili do të bënte të mundur vazhdimësinë e kësaj familjeje në Ulqin.²⁹ Ka mundësi që Barnaba që u arratis nga Durrësi, mund të ketë qenë i njëjti person me Barnaba Bruton e lartpërmendur, të atin e Piero Brutit. Pra, siç u pa edhe më lart, vazhdimësia e familjes Bruti në Durrës është mjaft e pashkëputur që nga shek. XIII e deri në vitin 1501 që shënon pushtimin e këtij qyteti nga osmanët.³⁰

Largimin e Brutëve nga Durrësi, në vitin 1501, të dhëna të tjera, përveç se me Barnaban, e lidhin edhe me Antonio Brutin, i cili vendoset në Ulqin dhe bëhet fisnik i këtij qyteti,³¹ por këtu mund të ketë ndonjë keqkuptim apo ndonjë gabim nëpër burime pasi Antonio Bruti³² u lind në vitin 1518, mesa duket në Lezhë apo në Ulqin, ku banoi edhe pjesën më të madhe të jetës së tij, dhe ku përshkruhet si një burrë fisnik jashtëzakonisht i virtytshëm dhe shumë besnik ndaj Sinjorisë venedikase.³³ Pra, i bie të jetë i brezit të dytë të familjes Bruti në Ulqin.³⁴

²⁷ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, pa f. (gjenealogjia)

²⁸ *Nuovo Dizionario Istorico ovvero Storia In Compendio*, Tomo III, Bassano: 1796, f. 383.

²⁹ *Po aty*.

³⁰ N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 25.

³¹ S. Žitko, "Plemiška Družina Bruti...", f.101.

³² [Pa autor], "Kush ishin agjentët shqiptarë të Perandorisë Osmane", në *Gazeta Telegraf*, datë 15.06.2015.

³³ N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 23.

³⁴ Megjithatë edhe Giuseppe Bonzio thotë për Antonion se iku nga Durrësi dhe u vendos në Ulqin, u emërua madje edhe Kavaljer me një dekret të Senatit Venedikas. G. Bonzi, *Ne funerali dell Illustriss ...*, f. XV.

Ky person del i dokumentuar që në vitet 30 të shek. XVI, deri me Luftën e Qipros dhe me Betejën e Lepantos në vitin 1571.³⁵ Megjithatë Venturini e vendos atë si banues për një farë kohe në Lezhë, qytet të cilin u detyra ta braktiste duke lënë në dorën e turqve çdo pronë të tijën, për të mbërritur pastaj në Ulqin i varfëruar krejtësisht, i veshur në lecka (lacero) e i uritur³⁶, në shoqërinë e dy motrave të tij të cilat i martoi, njërën tek Dukagjinët kurse tjetrën tek familja fisnike Suinja.³⁷

Prona që ai braktisi në Lezhë duhet të ketë qenë mjaft e madhe për shkak të marrëdhënieve dhe lidhjeve tregtare që kishte pasur me qytetet përreth.³⁸ Në Ulqin ai u bë komandat i një brigantine venedikase dhe aktiviteti i tij ushtarak është i mbushur plot me heroizma, ndër të cilat mund të përmendim këtu pjesëmarrjen e tij në mbytjen e anijeve (vescielli) të piratit të famshëm Barbarossa dhe luftën që bëri kundër ushtrisë turke nën drejtimin e sanxhakbeut të Shkodrës, Mustafa për shpëtimin e Dukagjinit,³⁹ ngjarje kjo që duhet të ketë ndodhur diku në gjysmën e dytë të shek. XVI, por që nuk është e njohur në detaje. Emri i tij përmendet edhe në një dokument të datës 23 prill 1553 në lidhje me një koncesion toke dhënë atij me kontratë nga Augustin Nigri, rektor dhe abat i Manastirit të Shënkollit të Bunës. Për rëndësinë që ka ky dokument, po e japim të plotë si më poshtë:

“[Jakob Dugario, në emër edhe të «Augustin Nigrit, rektorit abat ... të abacisë së quajtur Shënkollit i Bunës» ka parashtruar se, më parë ai vetë] me dëshirë ta bënte më të mirë gjendjen e atij Augustini dhe të kishës së sipërthënë dhe të mendonte për dobinë e tyre, i dha dhe i shënoi si emfitues të përhershëm birit të dashur Anton Brutit, laik (shekullar) i qytetit të Ulqinit ... një tokë që gjendet brenda caqeve të fshatit Geram të asaj dioqeze ... nga e cila pothuaj nuk merrej asgjë, me një qira apo detyrim, ndaj atij Augustini ose të rektorit të kësaj kishë që do të jetë kohë pas kohe, dy karte grurë të qëruar, që çdo vit do të paguhen në kohën e korrjes, sikundër [parashikuese] thotë se del në instrumentin publik të bërë për këtë... [Antoni kërkon pra që t'i vërtetohet ky koncesion dhe pasi të bëhet shqyrtimi, nëse çdo gjë është

³⁵ S. Žitko, “Plemiška Družina Bruti...”, f.101.

³⁶ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, f. 9.

³⁷ N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 26.

³⁸ Po aty.

³⁹ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, f. 10.

në rregull, se është për dobinë e kishës dhe se nuk çënohen të drejtat e tjetërkujt, të bëhet vërtetimi”⁴⁰.

Si rrjedhojë e kësaj kërkesë për vërtetim, Papa në lidhje me këtë koncesion porosit kryepeshkvin e Tivarit dhe ipeshkvin e Ulqinit për të bërë hetime në lidhje me këtë koncesion, me qëllim që nëse ai është i rregullt të vërtetohet⁴¹. Emri i tij na del edhe në dokumente të tjera të viteve 1559⁴² dhe 1570⁴³, ku përmendet si tregtar gruri dhe besnik i venedikasve.

Antonio II Bruti ishte pra një tregtar, luftëtar dhe diplomat i njohur për kohën. Ai vepronte “si një ndërmjetës mes Venedikut dhe Stambollit në mbikëqyrjen e tregtisë jetike të grurit dhe në manipulimin e një rrjeti kristiano-otoman dhe të lidhjeve personale dhe aleancave që e bëjnë të pakuptimtë ndarjen mes dy kulturave që tradicionalisht kanë karakterizuar kuptimin tonë mbi Rilindjen.”⁴⁴ Si i tillë ai pati një sukses aq të madh sa që Duka i Venedikut e emëroi Antonio (II) Brutin në vitin 1559, kalorës të Urdhrit të Shën Markut, duke fituar gjithashtu edhe merita e tituj të tjerë për shkak të veprave të tij heroike në shërbim të Republikës së Venedikut.⁴⁵

Në një dokument të datës 17 maj 1570 në lidhje me tregtinë që bënte me Venedikun, Antoni përmendet me urdhrin e kalorësit dhe pronar i një anije brigandine që transportonte grurë në Venedik, por që ndalohej nga podestai i Budvës për shkak të një nevoje të madhe (për shkak të luftës me turqit, murtajës dhe urisë, si dhe për shkakun e Pastroviqëve të uritur që kërcënonin se do të plaçkitnin qytetin). Si rrjedhim ai kërkon falje në Venedik.⁴⁶

Për këtë ndalesë të brigandinës në një dokument tjetër po të muajit maj 1570 jepet një version tjetër, ku thuhet se “meqënëse në këtë liman u gjet një brigandinë me grurë të ngarkuar prej të madhërishmit kalorës Bruti për llogari të Sinjorisë sonë të përndritur e shumë të shkëlqyer, ne

⁴⁰ *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, Vëll. I (1507 - 1592), nr. 188.

⁴¹ *Po aty*.

⁴² “1559, Ulqini dhe Tivari në relacionin e sindikëve Mikel Bon dhe Gaspare Erizzo”, në *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, Vëll. I (1507 - 1592), nr. 201 (f. 116).

⁴³ *Po aty*, nr. 225, 226.

⁴⁴ [Pa autor], “Kush ishin agjentët shqiptarë të Perandorisë Osmane”, në *Gazeta Telegraf*, datë 15. 6 2015.

⁴⁵ S. Žitko, “Plemiška Družina Bruti...”, f.101.

⁴⁶ *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, vëll. I (1507 - 1592), nr. 225.

gjykatës e prokuratorë, përfaqësues të kësaj bashkësie shumë besnike, së bashku me shumë qytetarë të tjerë si: kapedanë, ushtarë e stratiotë i lutëm zotërisë suaj shumë të qartë që të bënte të shkarkohej gruri i sipërthënë për të ushqyer [njerëzit] shumë besnikë të kthjelltësisë së saj [Republikës]”.⁴⁷

Në një ngjarje tjetër ky përmendet si person që ka marrë pjesë në luftën e përgjakshme midis “banorëve” të Lezhës që i përkiste tashmë Perandorisë Osmane (*cittadini die Alessio turca*) dhe ulqinakëve që i përkisnin Republikës së Venedikut (*dulcignotti veneti*). Turqit kishin kapur dhe shitur një anije të madhe të tipit “*marciliana*”⁴⁸ që i përkiste venedikasit Alvise Vendramin (*il magnifico missier Alvise Vendramin*).

Antonio Bruti i detyroi grabitësit që t/i jepnin shumën e parave që kishin përfituar nga shitja.⁴⁹ Kurse në një rast tjetër, së bashku me Cristoforin, Kapitenin e Kanalit, ai ndoqi piratin turk Hasan deri brenda portit të Durrësit që tashmë i përkiste osmanëve. Antoni zbarkoi në portin e qytetit nga e kishte edhe origjinën dhe duke mos pasur frikë nga numri i madh i jeniçerëve që dolën përkrah cubit, e detyroi atë që të bënte një premtim me shkrim në prezencën e kadiut, duke deklaruar që ai nuk do të shqetësonte më nënshtetasit e Serenissimas.⁵⁰

Përsa i përket lidhjeve të Antonios me familjet fisnike shqiptare, mund të themi që e shoqja e tij i përkiste familjes fisnike Bruni nga Ulqini. Brutët ishin lidhur me familjen Bruni edhe më herët dhe si një lidhje të tillë mund të përmend këtu martesën e Lucia Brutit me Stefano Brunin, të dokumentuar në vitin 1524, pra një brez më përpara se Antoni i lartpërmendur. Brunët e Ulqinit në fakt duhet të kenë qenë nga Shkodra⁵¹, me origjinë mbase nga Venediku dhe të vendosur në Shkodër që në shek. XI,⁵² por më vonë ata mesa duket qenë shpërngulur për në Ulqin, për shkak të pushtimit të Shkodrës dhe të krahinave përreth saj nga turqit në vitin 1479.

⁴⁷ *Po aty*, nr. 226.

⁴⁸ Marrë nga: La Marciliana: URL: <http://www.marciliana.com/la-marciliana> (10. 9. 2015)

⁴⁹ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, f. 10.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ D. Venturini, *La famiglia Albanese ...*, f. 8; Shih edhe N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 24.

⁵² N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 24.

Kunati i Antonio Brutit që Giovanni Bruni, i cili u bë më vonë argjipeshkëv i Tivarit, duke qëndruar si i tillë për një kohë mjaft të gjatë, nga viti 1551 deri në vitin 1571.⁵³ Si argjipeshkëv i Tivarit problemet e një dioqeze në territoret e pushtuara osmane dhe konkurrencën e rivalëve të besimeve ortodokse serbe dhe luteriane. Pozicioni i Giovanniit, duke punuar në vijën e frontit kundër ndryshimeve që konsideroheshin si “herezi” për kishën, tërhoqën vëmendjen e Papatit, që në vitin 1562 e thirri atë për të drejtuar kundërreformën e Koncilit të Trentit (1545 – 63), pra përpjekjen e Kishës Katolike për të vendosur rregull në shtëpinë e saj dhe për t’iu përgjigjur sfidës së Protestantizmit.




Fig. 2: Lidhja e Brutëve me Brunët e Ulqinit. Marrë nga N. Malcolm, *Agents of Empire*, pa nr. faqeje

Sa i përket prezencës së kryepeshkëvit të Tivarit në Koncilin e Trentit, kemi hasur në një problem që tani për tani nuk mund të marrë një sqarim të kënaqshëm, sepse sipas një përshkrimi gjeografiko-historik për Mbretërinë e Serbisë (Kosovë, etj.) dhe krahinave të tjera përreth nga një autor anonim në vitin 1651, në katalogun e legatëve kryepeshkopë të Julit III gjatë këtij koncili del i pranishëm “Gjon Bruti ... i mbretërisë së Serbisë, Primat Kryepeshkop i Tivarit” (*Johannes Brutius (?) de Regni*

⁵³ Po aty.

Servia Primas Archiepiscopus Antibarensis)⁵⁴. “Ndërsa Giovanni ndoqi rrugën e tij fetare, vëllai i tij Gasparo rrëmbeu shpatën dhe iu bashkua Kalorësve të Maltës më 1567, pikërisht në kohën kur sulltani i ri osman, Selimi II kërcënoi me një fushatë të madhe detare kundër Maltës dhe interesave spanjolle – venedikase në të gjithë Mesdheun.⁵⁵

Në vitin 1571, Ulqini u pushtua nga osmanët dhe qe një ndër qytetet e fundit shqiptare që ranë nën sundimin e kësaj perandorie. Antonio Bruti u vra në luftë për mbrojtjen e qytetit të tij të lindjes që u mor pastaj nga turqit.⁵⁶ Edhe kunetërit e tij që i përkisnin familjes Bruni nuk patën aspak një fat më të mirë: Giovanni fillimisht u burgos nga turqit, por më vonë mesa duket u la i lirë, kurse Gasparo që u bë i dyti në komandën e aleancës detare të krishterë dhe u përball me flotën otomane në tetor 1571⁵⁷, u vra në Betejën e Lepantos. Për trimëritë e tij qe shpërblyer duke u vënë në krye të një komande në fund të viteve 1570 për të mbrojtur enklavën papale në Avinjon, nga një tjetër armik heretik, kësaj here nga francezët protestantë huguenotë. Ai dërgoi djalin e tij, Antonion Brunin, në një shkollë jezuite në Romë ku studioi për drejtësi dhe që prej 1580 do të ndihmonte kushëririn e tij, Bartolomeo Brutin të administrojë Moldavinë.⁵⁸



Fig. 3: Agostino Bruti

⁵⁴ *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi. St. Gallen/Prishtinë: albanisches institut & Faik Konica 2015, nr. 153, fl. 2.

⁵⁵ [Pa autor], “Kush ishin agjentët shqiptarë të Perandorisë Osmane”, në *Gazeta Telegraf*, datë 15.06.2015.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 24.

⁵⁸ [Pa autor], “Kush ishin agjentët shqiptarë të Perandorisë Osmane ...”, në *Telegraf*, datë 15.06.2015.

Fat të keq pati edhe Giovanni i sipërpërmendur, argjipeshkvi i Tivarit. Ai u vra ndoshta 100 jarda larg vëllait të tij Gasparo, në bordin e një anije papnore, edhe pse ajo nuk ra në duart e osmanëve, por të disa piratëve spanjollë, të cilët e ekzekutuan teksa ai po thërriste: “Jam peshkop, jam i krishterë”⁵⁹. Ky ekzekutim duhet të ketë ndodhur pikërisht në vitin 1571.⁶⁰ Në lidhje me këtë ekzekutim, na jep disa të dhëna më tepër imzot Pjetër Bogdani në një relacion të tij të datës 24 mars 1684. Aty Bogdani shkruan që “ky [ipeshkvi] qe futur prej turqve në rrem si një skllav dhe pastaj, si qe kapur ajo galerë prej të krishterëve, të cilët vonë i shkuan në ndihmë, duke parë në atë sulm [atë peshkop] kaq të këputur e të keqpërdorur, duke menduar se mos ishte turk, ata tanët ia shkurtuan kokën atij të mjeri prelat.”⁶¹ Çuditërisht, relacioni anonim i vitit 1571 që përmendëm më sipër na njofton edhe për një prelat tjetër të Kishës të dalë nga kjo famije, i cili ishte Imzot Antoni Bruti, (*ms. Antonio*),⁶² por këtu mbase bëhet fjalë për ndonjë ngatërresë me Antonio Brutin që ka jetuar gjatë shek. XVI, për të tilin folëm tashmë më lart.

Me pushtimin e Ulqinit pësoi një goditje edhe ekzistenca e kësaj familje si në këtë qytet, ashtu edhe në trojet shqiptare në përgjithësi, duke u larguar përgjithmonë nga Shqipëria e duke u vendosur në Capodistria (Koper). Ishin pikërisht të bijtë e Antonio Brutit, Giacomo dhe Marco, luftëtarë në ushtrinë venedikase dhe pjesëmarrës si i ati i tyre në Betejën e Lepantos, ata që morën rrugën e largimit nga atdheu, pas vdekjes së babait të tyre më 7 tetor 1571.⁶³

Nga familja Bruti, edhe pas largimit të tyre nga trojet shqiptare kanë dalë edhe njerëz të tjerë të suksesshëm që bënë emër qoftë në Ballkan, qoftë në trojet italiane apo në Perandorinë Osmane. Ndër pasardhësit e kësaj familjeje mund të përmendim këtu Bartolomeo Brutin e lartpërmendur, i cili punoi qoftë për Venedikun qoftë për Stambollin dhe shumë shpejt u rekrutua nga spanjollët (me pagesë) dhe nga venedikasit

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ N. Malcolm, *Agents of Empire ...*, f. 24.

⁶¹ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëllimi IV (1675-1699), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha, Tiranë: Akademia e Shkencave (Instituti i Historisë) 1990, nr. 6 (f. 26).

⁶² *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, vëll. I (1507 - 1592), nr. 231, f. 296.

⁶³ S. Žitko, “Plemiška Družina Bruti...”, f.101.

si spiun⁶⁴, për të bërë në vitin 1577 bisedime rreth një paqeje të dëshiruar nga Madridi⁶⁵ dhe më vonë duke ndërmjetësuar marrëveshje me Vezirin e Madh të Perandorisë Osmane (që për fat do ta kishte të afërm)për të emëruar vojvodën e ri në Moldavi.⁶⁶

Në vitin 1592, kur vojvoda i ri u emërua, Bartolomeo i rriti kërkesat, aq sa e vranë dhe e hodhën në Dniester (ndonëse Malcolm ka zbuluar një tjetër dimension të vrasjes së tij, një grindje tërësisht më prozaike për çështje parash).⁶⁷ Ndikimi i klanit arriti aq larg, deri në veprimtarinë si agjentë të Mbretëreshës Elizabetë I. Më 1596, Edward Barton, ambasadori anglez në Stamboll udhëtoi me Sulltan Mehmetin III përmes Hungarisë në shoqërinë e përkthyesit të tij që ishte Pasquale Bruti, një nga nipat e Bartolomeos së lartpërmendur. Fatkeqësisht edhe Pasquale pati të njëjtin fat si xhaxhai i tij. Ai u vra nga autoritetet osmane në Beograd në vitin 1597, i dyshuar si spiun.⁶⁸

III

Siç e thashë edhe më sipër familja nxori shumë klerikë të njohur të cilat dhanë një kontribut të rëndësishëm në jetën dhe në kulturën e qyteteve ku u vendosën. Si shembull mund të përmend këtu ipeshkëvijtë e dalë nga kjo familje. Si të parin po rendis ipeshkvin e Ulqinit, Antonio Brutin,⁶⁹ i cili duhet të ketë figuruar si ipeshkëv i Ulqinit në gjysmën e parë të shek. XVI⁷⁰, megjithatë mbi të nuk kemi të dhëna dhe Farlati e përmend Antonio Brutin në Ulqin si prokurator⁷¹ e jo si ipeshkëv. Këtu mund të përmendet sërish argjipeshkvi i Tivarit Gjon Bruti “*Johannes Brutius (?) de Regni Servia Primas Archiepiscopus Antibarensis*”⁷² për të cilin thamë edhe më sipër që hëpërhë nuk mund të vërtetohet me saktësi si i tillë, ose mbase këtu bëhet fjalë për Gjon Brunin⁷³, argjipeshkvin e

⁶⁴ Nicolae Jorga, *Geschichte des Osmanischen Reiches: Dritter Band: bis 1640*. Paderborn: egv 2011, f. 264.

⁶⁵ *Po aty*, f. 160.

⁶⁶ [Pa autor], “Kush ishin agjentët shqiptarë të Perandorisë Osmane ...”, në *Telegraf*, datë 15.06 2015.

⁶⁷ *Po aty*.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ G. Bonzi, *Ne funerali dell Illustriss ...*, f. XVII.

⁷⁰ D. Farlato, *Illyricum Sacrum ...*, f. 259.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653) ...*, nr. 153, f. 2.

⁷³ *Dokumente të shekujve XVI-XVII ...*, vëll. IV (1675-1699), nr. 6, f. 26.

Tivarit, të përmendur më lart, pjesëmarrës gjithashtu në Koncilin e Trentit, por që gabimisht mund t'i jetë shkruar emri Bruti në vend të Bruni.

Më tej ia vlen të përmendim ipeshkvin e Cittanovas në Istria Jacopo (Giacomo) Bruti (1628-1679), i cili vdiq më 1688.⁷⁴ Ipeshkvi tjetër i radhës i dalë nga kjo familje qe Agostino Bruti, ipeshkëv i Justinopolit (Capodistria/Koper) (ipeshkëv gjatë periudhës 28 shtator 1733 - tetor 1747).



Fig. 4: Pallati Bruti në Koper (Slloveni), sot Biblioteka e qytetit. Foto nga E. Malaj

Agostino Bruti është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për historinë e familjes Bruti por edhe për historinë e kishës katolike të qytetit të Capodistrias, kësaj figure si përfundim po i kushtoj disa rreshta. Agostino Bruti u lind në Kapodistria në maj të vitit 1682. Ai e filloi karrierën e tij klerikale në Kapodistria si këshilltar i Inkuizicionit⁷⁵.

Pastaj kaloi në Romë në cilësinë e sekretarit të memorialëve dhe si kamerleng (maestro di camera) në oborret e dy ambasadorëve venedikas. Si rezultat i meritave të tij nga Republika Venete iu dha Abacia e Asolos. Meritat e tij e bënë që në vazhdim të shugurohej nga Papa ipeshkëv i Caneas, dhe kështu në vitin 1734 u transferua në atdheun e tij në Katedralen e Kapodistrias, ku qëndroi si i tillë për 13 vjet e 8 muaj deri në vitin 1747 që është edhe viti i tij i vdekjes.

Në maj të vitit 1737 ai organizoi Sinodin e parë të Dioqezës së Justinopolit (pra të Kapodistrias) duke rishikuar dhe sistemuar edhe një herë çështje të ndryshme të kësaj dioqeze, në frymën e Koncilit Tridentin.⁷⁶ Ai u mundua që të instauronte një jetë më intensive dhe më

⁷⁴ S. Žitko, "Plemiška Družina Bruti...", f. 55.

⁷⁵ P. Stancovich, *Biografia degli uomini distinti ...*, I, f. 472-473.

⁷⁶ Augustinus Co: de Brutis, Justinopolitanae Diocesis sacrae constitutiones quas in sua prima synodo In Cathedrali celebrata diebus 6.7.8. Maji 1737, promulgandas curavit Illustrissimus, et Reverendissimus in Christo Pater D. Augustinus Co: De Brutis, Episcopus Justinopolitanus, Comesque Antignani etc, Venetiis MDCCXXXVIII.

të disiplinuar kishat, pra duke e vënë theksin më tepër tek jeta praktike e krishterë, sesa tek problemet në lidhje me çështje dogmatike të fesë.⁷⁷

Veprat e tij janë:

- Augustinus Co: de Brutis, Justinopolitanae Diocesis sacrae constitutiones quas in sua prima synodo In Cathedrali celebrata diebus 6.7.8. Maji 1737, promulgandas curavit Illustrissimus, et Reverendissimus in Christo Pater D. Augustinus Co: De Brutis, Episcopus Justinopolitanus, Comesque Antignani etc, Venetiis MDCCXXXVIII.
- Augustinus Co: de Brutis, Appendix in Synodo dioecesana Justinopolis, Venetiis MDCCXXXVIII.
- (Občina Koper), Per la magnifica citta di Capodistria C. monsignor vescovo Brutti, Capodistria 1745.
- Në shkrimet e tij Agostino Bruti u mundua që të forconte autoritetin e ipeshkvit dhe rëndësinë e sakramenteve me qëllim që jeta e krishterë të kishte një praktikë sa me të dendur,⁷⁸ duke pasur parasysh këtu edhe frymën e Koncilit Tridentin.
- Vepër e tij është edhe pallati Bruti ekzistente edhe sot e kësaj dite në qendër të Kapodistrias.

Këtu ja vlen të përmenden edhe ndikime të tjera të rëndësishme të tij në fushën ndërtimore si zmadhimi i ndërtesës së Seminarit dhe zmadhimi i Katedrales aguste⁷⁹ që është një krenari për qytetin e Koperit edhe sot e kësaj dite.

Kjo familje u shua aty nga gjysma e shek. XIX dhe pinjulli i fundit i saj ishte Barnaba Konte Bruti, i cili qe podesta (kryebashkiak) i Koperit (Capodistria) të Sllovenisë gjatë viteve 1818- 1822.⁸⁰ Këto ishin pra disa të dhëna të përgjithshme mbi familjen fisnike shqiptare Bruti, e cila është e dokumentuar që në shek. XIII, por që u bë e njohur kryesisht gjatë shekujve XVI-XVIII.

⁷⁷ Peter Štoka, “Knjižna dela Koprškega Škofa Agostina Grofa de Brutija ter falni gojor Kopersega literata Giusepija Bonzija, Benetke, 1748, Riassunto”, në *Il palazzo e la famiglia Bruti a Capodistria ...*, f. 173.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ Po aty, f. 174.

⁸⁰ Familjet fisnike shqiptare në Koprin e Venecisë, botuar si numër i veçantë në revistën *Illira*, nr. 2/2015, Koper, Slloveni, f. 22.

S u m m a r y

BRUTI, THE NOBLE FAMILY FROM DURAZZO

The Albanian noble family named Bruti originated from Durazzo has a long history. It begins with their origin in Durazzo in the 13th Century and ends in the 19th Century in the western-Slovenian City of Capodistria. In this article I am trying to bring an overview of their rich history, focusing especially in the ties, which this family had with other noble Albanian families during the Middle Age. As second I want to give information's about several personalities belonging to this family. As an example I can mention here the Bishop of Capodistria (Koper) Agostino Bruti, who played an important role in the early modern History of Church in Capodistria.